



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 64 prot.

Kamëz, më/Ë.05.2021

VENDIM

Nr. 53 .Datë 19/052021

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI DHE NJË SHTESE NË LISTËN E VENDIMIT NR.22 DATË 19.02.2021 SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT “PËR SHEMBJE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.05.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim Projekt – Vendim Nr.48 Datë 11.05.2021 në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit” Urdhërit nr. 632 datë 18.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të pocaçëm të rindërtimit për aplikuesit në lagjen 1 dhe lagjen 2 Kamëz sipas listës bashkangjitur, Urdhërit nr. 617 datë datë 11.12.2020 Për ngritjen e komisionit të pocaçëm të rindërtimit për aplikuesit në Njësinë Administrative Paskuqan sipas listës bashkangjitur, si dhe urdhërit nr. 616 datë 11.12.2020 Për ngritjen e komisionit të pocaçëm të rindërtimit për aplikuesit në lagjen bathore, sipas listës bashkangjitur,  
**Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KAMËZ**  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

1. Miratimin e një shtese në listën e subjekteve përfitues të Vendimit Nr.22 datë 19.02.2021, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit e shtëpive individuale sipas përbërjes familjare mbështetur ne V.K.M Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar pika V, tabela A.

Përbërja familjare	Sipërfaqja në metër katrorë (m2)	Masa e grantit
Deri në 2 anëtarë	60 m2 deri në 70 m2	Preventivi i projektit model
3 deri në 4 anëtarë	70 m2 deri në 80 m2	Preventivi i projektit model
5 e më shumë anëtarë	Jo më pak se 90 m2	Preventivi i projektit model

2. Lista e e subjekteve që shfuqizohen në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

3. Lista e subjekteve shtesë përfitues e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

